

VENDIM
Nr. 513, datë 1.8.2012

**PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË PRONËSISË SË DISA PARCELAVE NDËRTIMORE NË FAVOR
TË POSEDUESVE TË OBJEKTEVE INFORMALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, të shkronjës "ç" të nenit 4 të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e trojeve", të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të nenit 175 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalimit në pronësi të poseduesve të objekteve informale të sipërfaqeve të parcelave ndërtimore, të zëna, sipas listës dhe planvendosjeve përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi, përkatësisht:

a) Në qarkun Tiranë, 191 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 38 925,41 (tridhjetë e tetë mijë e nëntëqind e njëzet e pesë presje dyzet e një) m².

b) Në qarkun Durrës, 237 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 81 588,00 (tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë) m².

c) Në qarkun Shkodër, 777 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 98 339,80 (nëntëdhjetë e tetë mijë e treqind e tridhjetë e nëntë presje tetëdhjetë) m².

ç) Në qarkun Lezhë, 47 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 12 569,80 (dymbëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë presje tetëdhjetë) m².

d) Në qarkun Berat, 76 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 12 543, 64 (dymbëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet e tre presje gjashtëdhjetë e katër) m².

dh) Në qarkun Fier, 135 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 43 312,92 (dyzet e tre mijë e treqind e dymbëdhjetë presje nëntëdhjetë e dy) m².

e) Në qarkun Korçë, 47 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 6 621, 38 (gjashtë mijë e gjashtëqind e njëzet e një presje tridhjetë e tetë) m².

ë) Në qarkun Dibër, 17 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 3 412,30 (tre mijë e katërqind e dymbëdhjetë presje tridhjetë) m².

f) Në qarkun Elbasan, 236 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 47 797,20 (dyzet e shtatë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë presje njëzet) m².

g) Në qarkun Gjirokastrë, 48 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 15 610,70 (pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dhjetë presje shtatëdhjetë) m².

gj) Në qarkun Vlorë, 151 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 43 988, 50 (dyzet e tre mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë presje pesëdhjetë) m².

h) Në qarkun Kukës, 39 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 9 513,25 (nëntë mijë e pesëqind e trembëdhjetë presje njëzet e pesë) m².

2. Ngarkohet Agjencia e Legalizimeve, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimore Informale për kryerjen e procedurave të kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore të objekteve informale, nga shteti te poseduesi i ndërtimit pa leje.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha